



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

<i>Avdush Bajramaliu,</i> <i>Ekspert shqyrtues i jashtëm</i>	<i>Dt. e pranimit</i> <i>28.06.2022</i>	<i>Dt. e dorëzimit</i> <i>06.07.2022</i>	Nr. i lëndës: 236/22
---	--	---	---

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.06.2022, “**International Security Association**” SHPK-nga Prishtina, ka parashtruar ankesë me nr: 236/22, për aktivitetin e prokurimit të (AK) – **Keshilli Prokurorial i Kosovës**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Sigurimi fizik i objekteve të Sistemit Prokurorial të Kosovës**”, me nr. të prokurimit: 250-22-2969-2-1-1, nr. të brendshme: PSH250-022-006-211, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) **Keshilli Prokurorial i Kosovës**, Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur** lloji i kontratës: Kontrata Publike Kornizë-**SHËRBIM**, vlera e parashikuar e kontratës: **200 000,00**

SHENIM: (Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se ka pasur një vendim Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues..

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE të OE. Ankues

Njoftimi për kontratë: 07.04.2022
Afati për dorëzimin e ofertës : 18.05.2022 ora 10:00
Kërkesa për Rishqyrtim 20.06.2022
Vendimi për kërkesën për rishqyrtim 21.06.2022
Ankesa në OSHP. 27.06.2022
Pretendimet ankimore të Ankuesit ““**International Security Association**” SH.P.K.

Te nderuar

Duke pas parasysh se kompania jonë ka qenë pjesëmarrëse në këtë aktivitet prokurimi dhe ne kemi dërguar ofertën tonë, duke pas të drejtën e kërkesës për rishqyrtim brenda afateve ligjore kemi bërë kërkesën për rishqyrtim pranë AK, mirëpo ankesa jonë ka hasur në kundërshtim nga AK, e që sipas nesh na është bërë një e padrejtë sepse pikat e eliminimit të kompanisë sonë nga ky AP, nuk janë të qëndrueshme për arsye se

Sigurimi I tenderit nga kompania jonë të cilin po e bashkëngjeshim me këtë ankesë, është bërë

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga “**International Security Association**” SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave në objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale**”, me nr. të prokurimit: 250-22-2969-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti kontraktues (AK) – **Keshilli Prokurorial i Kosovës**

dhe ka qenë valid për 121 ditë e jo sipas pretendimit të AK se ky sigurim tenderi është valid për 119 ditë, dhe është kërkuar që të jetë për 120 ditë. Keni parasysh se dita e parë e hapjes së ofertës nuk llogaritet kur bëhet sigurimi I ofertës dhe llogaritja e ditëve të sigurimit bëhet sipas kalendarit, ku poashtu duhet të kemi parasysh se ka muaj që brenda afatit të validitetit të sigurimit të ofruar janë me 30 ditë, ne se kuptojmë se si kanë llogaritur validitetin e këtij sigurimi AK.

Ne gjithashtu kemi ofruar dëshmi edhe për pikën tjetër të arsyes së eliminimit të kompanisë sonë nga AK e që ka qenë se nuk kemi ofruar një deklaratë të nënshkruar se posedojmë të gjitha pasjisjet për kryerjen e shërbimeve të sigurimit e që në fakt një deklaratë e tillë ka qenë e ngarkuar në system dhe ne e kemi dëshmuar duke I dërguar AK kërkesën për rishqyrtim ku kemi bashkëngjitur deklaratën

Ne gjithashtu kemi ofruar dëshmi edhe për pikën tjetër të arsyes së eliminimit të kompanisë sonë nga AK e që ka qenë se nuk kemi ofruar një deklaratë të nënshkruar se posedojmë të gjitha pasjisjet për kryerjen e shërbimeve të sigurimit e që në fakt një deklaratë e tillë ka qenë e ngarkuar në system dhe ne e kemi dëshmuar duke I dërguar AK kërkesën për rishqyrtim ku kemi bashkëngjitur deklaratën

KRITERET PËR VLERËSIM

Dokumentet te cilat do te kërkohe si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon:

Kërkesat e përshtatshmërisë:	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
<i>a).Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04 L-042.për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 .Neni 65.</i>	<i>a).Në deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosijen e tenderit.</i>
<i>b)Një dokument nga Administra Tatimore e vendit tuaj të themelimit,se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.</i>	<i>b).Vërtetim nga Administrata Tatimore(kopje).</i>
<i>c)Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmeris të jetë ilëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës</i>	<i>c).Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për Qështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose ivërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit). Dokumentet (nën b dhe c) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues,para publikimit të dhënies së kontratës. Në rast të dështimit në dorzimë të dokumentave të tilla,tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar të radhës.</i>

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga “**International Security Association**”SHPK. lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale**”, me nr. të prokurimit: 250-22-2969-2-1-1, iniciuar nga **Autoriteti kontraktues (AK)** – **Keshilli Prokurorial i Kosovës**

Përshtatshmëria profesionale: <i>Kërkesa1 Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo Regjistrin e ndermarjeve në vendin e juaj të themelimit</i>	Dëshmia e kërkuar dokumentare: <i>1 Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje).</i>	
<i>Kërkesa2 Regjistrimi i TVSH</i>	<i>2 Certifikata e TVSH-kopje.</i>	
<i>Kërkesa3 Regjistrimi i Numrit Fiskal</i>	<i>3 Certifikata e numrit fiskal-kopje</i>	
Kapaciteti ekonomik dhe financiar: <i>1. Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi bankar i Operatorit Ekonomik,gjat tre vite të fundit fiskal duhet te jete jo më pak se 400.000.00 Euro</i>	Dëshmia e kërkuar dokumentare: <i>1.Raporti bankar (vërtetim) apo ndonjë dëshmi tjetër zyrtare financiare qe dëshmon qarkullimin financiar për tri vitet e fundit fiskal.</i>	
Kapaciteti teknik dhe profesional: <i>1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyres se ngajshme,ne tri vitet e shkuara nga data e pubikimit te njoftimit per kontrate. ne vlerë prej jo më pak se 300,000.00€</i>	Dëshmia e kërkuar dokumentare <i>Deshmia 1.Lista e kontratave te realizuara ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit per kontrate duhet te dorzohet e skenuar origjinale te jete e nenshkruar dhe e vulosur nga OE.Duke specifikuar emrin e projektit,shumen e kontrates,daten e fillimit dhe te mbarimit te kontrates dhe referenca apo raporte te pranimit teknik.Referencat apo raportet e pranimit teknik duhet te korresponojne ne listen e kontratave</i>	
<i>2.OE duhet të caktoj menaxherin e projektit i cili është i licensuar nga MPB si menaxher i sigurimit në detyrë për shërbimin themelor.</i>	<i>2.Të dëshmohet me CV, minimum diploma e shkollës së mesme, licensa adekuate e menaxherit zyrtarit në detyrë për shërbimet themelore të sigurisë (valide), parakontrate ose kontrate te pune</i>	
<i>3.Oe duhet te jete e certifikuar me ISO 27001 2013</i>	<i>3.Certifikata ISO 27001 2013 Kopje e noterizuar</i>	
<i>4.Oe duhet te jete e certifikuar me ISO 45001</i>	<i>4.Certifikata ISO 45001 Kopje e noterizuar</i>	
<i>5.Oe duhet te jete e certifikuar me ISO 9001 2015</i>	<i>5.Certifikata ISO 9001 2015 Kopje e noterizuar</i>	

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga “**International Security Association** ”SHPK. lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale**”, me nr. të prokurimit: 250-22-2969-2-1-1, iniciuar nga **Autoriteti kontraktues (AK)** – **Keshilli Prokurorial i Kosovës**

6.Licenca e e vezhgimit elektronik të pronës,Çertifikata e qendres se kontrollit	5.Licenca për vezhgin elektronik të pronës,kopje dhe çertifikatë e qendres se Kontrollit - valide (kopje)	
7.Operatori Ekonomik duhet të posedoj më së paku 7 Automjete patrulluese OE mund të ofrojnë edhe marrëveshje me një kompani për shfrytëzimin e veturave (Rent a Car), kompania duhet të jetë e regjistruar si veprimtari për dhënie të veturave me qera pra Rent a Car. (valide).	7.Të dëshmohet me kopjet e librezave të regjistrimit të Automjeteve (me validitet regjistrim), dhe se Automjetet duhet të jenë të regjistruara në emrin e Operatorit Ekonomik apo marrveshja me kompaninë (Rent a Car) dhe kopjet e librezave valide në emër të kompanive Rent a Car.	
8.Operatori duhet të ketë të gjitha pajisjet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të sigurimit themelor, si Breza, Shufra, Pranga, Bateri ndriqese, Radio Lidhje mobile dhe fikse etj, pasqyra për kontrollimin e automjeteve, si dhe uniformat e punës ti prezantoj.	8. Të dëshmohet me licencë, raport dhe foto për secilën - (kopje). SHËNIM Në lidhje me këtë pikë (nr.6), ky kriter mbulohet me Licencën për Shërbime Themelore të Sigurisë, konform Ligjit 04 L-004, duke ia bashkangjitur edhe si dëshmi një raport mbi paisjet teknike me fotografi dhe Njoftim të MPB-së. OE poashtu duhet të dëshmoj se ka paisje dhe uniformat të mjaftueshme në dispozicion përmes një deklarate të vulosur dhe nënshkruar.	
9.Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit fizik ,Licenca nga autoriteti përkatës në R. e Kosovës- MPB -m autorizim.	9.Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së lëshuar nga MPB(per roje fizike) dhe autorizimi për nisjen fillestare të veprimtarive të lëshuara nga MPB, sipas Ligjit për Shërbimet Private te Sigurisë nr. 04 L-004; (valide)	

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Ne raportin e vlersimit te ofertave OE- ankuese eshte vlersaur si OE- i papegjegjeshem sepse nuk i ka plotsuar kriteret e pershtatsmerive profesionale e ,sepse i mungojn paisjet per sherbime tre sigurimit themelor,po ashtu edhe veliditeti i ofertes ne raportin e vlersimit ka dalur te jete 119 dite e jo 120 sipas kriterit te kerkuar nga AK.-Keto mangesi theksohen ne raportin e vlersimit te AK-se.

(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës OE ankues /ofertave, por të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga “**International Security Association** ”SHPK. lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale**”, me nr.të prokurimit: 250-22-2969-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti kontraktues (AK) – **Keshilli Prokurorial i Kosovës**

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet njëvlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

OE- ankuese është pale me interes në këtë procedurë sepse ka dorëzuar ofertë dhe gjatë vlerësimit ka dalur të jetë si OE- i pasukseshëm në aspektin e çmimi me të lirë të poentuar.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES:

“International Security Association” SHPK

Sqarimi i lëndës nga eksperti shqyrtues

- Përgjigjeje e pretendimit ankimor nr.1 për validitetin e sigurimit të tenderit.

Ky pretendim ankimor i OE-se ankuese është i bazuar sepse nga shkresat e lëndës shihet sigurimi i tenderit ka validitet bile me shumë se sa është kërkuar. Sigurimi i tenderit është nxierr më dt.18.05.2022 dhe ka validitet deri më 16.09.2022,

Një llogaritje e thjeshtë po të bëhet del ky rezultat. Sigurimi i tenderit i ka mbuluar këto ditë sipas mujave kur është nxierr:

Maj 14 ditë

Qershor 30 ditë

Korrik 31 ditë

Gusht 31 ditë dhe

Shtator 16 ditë, pra $14+30+31+31+16=122$ ditë, këtij sigurimi edhe po të mos i llogariten edhe ditat kur është nxierr pra 18 Maj 2022 po ashtu edhe ditat kur ka përfunduar, dt.16 Shtator 2022, ky sigurim prap mbetet me validitet sipas kushteve të NJK-se dhe Dosjes së tenderit, për gjdo rast po ua bashkangjesim edhe sigurimit të tenderit në fjalë:

Dëshmi Sigurimi I tenderit...

PRISIG
KOMPNIA E SIGURIMEVE - INSURANCE COMPANY

DEKLARATA E GARANTUESIT
Sigurim Tenderi

Serial: 0600101820193

Për **Keshilli Prokurorial i Kosovës**
(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

DUKE PATUR PARASYSH SE **International Security Association S.H.P.K.**
(emri i operatorit ekonomik, më tej "Tenderuesi")

Ka marrë përsipër të depozitojë sigurinë e tenderit që i referohet Dosjes së Tenderit, me Titill
Sigurimi fizik i objekteve të Sistemit Prokurorial të Kosovës, Nr. i Prokurimit:
250-22-2969-2-1-1 e dërguar nga Autoriteti Kontraktues:
(Nr. i referencës së Prokurimit)

DUKE PATUR PARASYSH SE Tenderuesi dëshiron të depozitojë një garanci për shumën e specifikuar në Dosjen e Tenderit:

DUKE PATUR PARASYSH SE jemi pajtuar që Tenderuesit j'i japim një garanci të titullit:
PRANDAJ NE nëpërmjet kësaj konfirmojmë se ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj jush në emër të Tenderuesit, deri në totalin prej: **€ 6,000.00**

Gjasht mije €
(Shuma e garancës me shifra dhe me fjalë)

dhe ne marrim përsipër t'ju paguajmë, pas kërkesës së juaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet se tenderuesi është në mungesë për shkak se:

- Autoriteti Kontraktues ka vendosur, duke u bazuar në fakte objektive të verifikuara se Tenderuesi ka dhënë Autoritetit Kontraktues informacione përmbajtësisht të gabueshme ose mashtruese; ose
- Tenderuesi ka tërhequr tenderin pas skadimit të afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të specifikuar në Dosjen e Tenderit; ose
- Tenderuesit i është dhënë kontrata përkatëse në bazë të tenderit të tij dhe Tenderuesi pastaj refuzon ose dështon:

- që të depozitojë çfarëdo sigurie të kërkuar të ekzekutimit që ishte specifikuar në Dosjen e
- që të përmbush çfarëdo kushti tjetër që ishte specifikuar në Dosjen e Tenderit, para nënshkrimit të kontratës përkatëse, ose
- të nënshkruajë një kontratë që përputhet me kushtet e specifikuara në Dosjen e Tenderit;

dhe pa ankim ose pa argument, çdo shumë ose shumat brenda **€ 6,000.00** limitive për të cilat u fol, pa pasur nevojë që ju të dëshmoni ose të demonstroi bazën ose arsyet e kërkesës së juaj ose ndaj shumës së specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës **18.05.2022** deri më **16.09.2022**

Lëshuar në **PRISHTINE** datë **18.05.2022**

Nënshkrimi dhe Vula e Garantuesve

PRISHTINE


0016411

Prandaj siq shihet edhe ne kete sigurim te tenderit qe e keni te bashkangjitur ,pretendimi ankimor i OE-se eshte i bazuar.

- Pergjigjeje ne pretendimin e dyte lidhur me deklaraten per paisjet per sigurim dhe licencen nga MPB.

Lidhur me pretendimin e dytë ankimor per at se OE-se ankuese i mungojn te bashkngjitura nje deklarate per paisje te deshmuar me foto ,me raport por edhe licencen per Sherbimet Themelore te Sigurimit,duhet theksuar se ky pretendim eshte pjesserisht i bazuar sepse nga shkresat e lendes,qe OE- ankuese ka ngarkuar ne sitem te prokurimit elektronik, shihet se Ky OE-e ka te bashkangjitur Raportin per paisjet me pershkrim detal te deshmura edhe me foto te plasjeve,po ashtu edhe Licencen per Sherbime Themelore te Sigurimit e Leshura nga Ministria e Punve te Brendshme me validitet deri me 25.03.2023. edhe per kete po u bashkangjesim deshmit qe kane qene te ngarkuar ne oferte te OE-se ankuese.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga **“International Security Association”SHPK.** lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale”**, me nr. të prokurimit: **250-22-2969-2-1-1**, iniciuar nga **Autoriteti kontraktues (AK) – Keshilli Prokurorial i Kosovës**



MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me lartë), eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues të OSHP-së që ankesa të pranohet si e bazuar, AK të anulon Vendimin për Anulim të tenderit dhe lenda të kthehet në Rivleresim.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues: **Këshilli Prokurorial i Kosovës**
- Panelit Shqyrtues: **OSHP-së**
- OE ankues: **“International Security Association” SHPK**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga **“International Security Association” SHPK**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave në objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale”**, me nr. të prokurimit: **250-22-2969-2-1-1**, iniciuar nga **Autoriteti kontraktues (AK) – Këshilli Prokurorial i Kosovës**